

FAQE E PARE

[Kontakt Standard](#)
[Politike](#)
[Analiza&Komente](#)
[Kronike](#)
[Kulture](#)
[Dossier](#)
[Intervista](#)
[Reportazh](#)
[Sociale](#)
[Ekonomi](#)
[Speciale](#)
[Kosove](#)
[Suplementi](#)
[Lajme nga Bota](#)
[Aktualitet](#)
[Rajon](#)
[Debat](#)

PRINTO

KOMENTO

Bajzë, largohen 18 ton pesticide në zonën më të ndotur në vend

BLERTA MRISHAJ

PNUD: Mbetjet do të ngarkohen për t'u shkatërruar në Angli

Popaj: Heqja e pesticideve liron 2 magazinat më të mëdha në Ballkan

Stacioni hekurudhor i Bajzës, në afërsi të liqenit të Shkodrës, nuk do të jetë më pikë e nxehtë mjedisore. Pas shumë kërkesash për të pastruar stacionin e Bajzës, në të cilin prej kohësh kanë qenë depozituar pesticide të nxjerra jashtë përdorimit në vendet e BE-së, falë projektit të PNUD dhe qeverisë shqiptare, zona do të rehabilitohet dhe pesticidet do të hiqen përfundimisht brenda 10 shtatorit.

Situata

Vladimir Popaj, drejtor i stacionit hekurudhor të Bajzës, tregon se prania e pesticideve në dy magazinat kryesore ka penguar aktivitetin kryesor të këtij stacioni. Pasi, sipas tij, në këtë stacion ka më shumë import dhe rreth 80% e tyre janë produkte ushqimore, çfarë nuk të lejon futjen e tyre në këto magazine. Por me pastrimin e këtyre magazinave nga PNUD, bëhet e mundur hapja e dy magazinave më të mëdha në Ballkan. Kjo do të shtonte ritmin e punës deri në 100%.

"Pastrimi i magazinave ka ardhur pas sensibilizimit të opinionit përmes 6 takimeve me komunitetin. Falë edhe punës, këto po hiqen duke hedhur hapa para për vënien në punë të këtyre magazinave. Pasi deri më tani nuk depozitoheshin mallra për shkak të pesticideve", - shprehet drejtori i hekurudhës Bajzë, z. Vladimir Popaj. Më tej, ai shton se kjo hekurudhë punon për të gjithë Shqipërinë, duke sjellë mallra nga e gjithë Evropa. Sipas Popaj, transporti me hekurudhë është më i leverdishëm sesa ai me kamion, pasi me tren transporti është deri në 50% më i lirë.

Luigj Isufaj, banor i zonës por edhe punonjës në stacionin e Bajzës prej 25 vitesh, tregon pasojat e pesticideve tek banorët e zonës dhe te punonjës të tjerë të stacionit. Ai pohon se banorët nga zonat përreth morën shumë prej fuçive duke zbratur kimikate toksike direkt në stacionin hekurudhor dhe zonat e depove. "Unë jam dëshmia e gjallë e pasojave që po vazhdojnë të shkaktojnë pesticidet. Tani vuaj nga disa sëmundje".

David Green, menaxher i firmës angleze "Arundelle", e ngarkuar për të bërë pastrimin dhe dërguar në Angli mbetjet ku do të asgjësohen në inceneratorë thotë: "Jemi duke kryer hapat e fundit për të përfunduar projektin mbi pastrimin e stacionit të Bajzës nga pesticidet. Po pastrojmë zonën, po bëjmë diferencimet, dokumentimin dhe heqjen e tyre përfundimtare deri më 10 shtator. Green thotë se nga këto magazine janë arritur të largohen 12 ton kimikate, si dhe 6 ton të përziera me lëkura, të gjitha këto do të shkojnë për t'u shkatërruar në Angli".

Bajza

Bajza është një zonë e vogël (Komuna Kastrat) e ndodhur në pjesën veriore të Shqipërisë, rreth 15 km nga qyteti i Shkodrës. Stacioni hekurudhor i Bajzës ndodhet në breg të liqenit të Shkodrës dhe i gjithë transporti hekurudhor nga Mali i Zi kalon nëpërmjet zhdoganimit në stacionin hekurudhor të Bajzës. Në fillim të viteve '90, sipas vlerësimeve, nga 200


[Kombetarja](#)
[Aktualitet Sporti](#)

[ME TE KOMENTUARA](#)

Topi firmos ligjin e Prokurorisë

Anila Jole, cdo dite jetoj nje histori

Oldashi: Rama të sjellë në ministri projektin e Unazës së Madhe

Fat i ndryshëm për vajza me bukuri të njëjtë...

Enver Lepenica: Përballë klithmave të korbave

PS: Qeveria të rishqyrtojë punësimin e përkohshëm

Atentati në Vienë, Zogu u kundërpërgjigj me armë

Bursa për master në Oksford, Jork, Suseks nga "Soros", si të përfitoni

Nga Athina në Sofje; Ndërprerja e gazit dhe ekonomia, protesta të dhunshme në Bullgari

BIZH-ja, 100 milionë \$ për

KURSI I KEMBIMIT

4 Shtator

	BLEJ	SHES
USD	96.20	99.00
EURO	121.29	124.82
GBP	148.47	152.79
CHF	81.33	83.70

SONDAZH

Si mund te zvoglojme numrin e aksidenteve rrugore dhe viktimave? Kopjoni linkun dhe votoni: <http://www.itsal.org/poll/index.php>

<http://www.itsal.org/poll/index.php>

 Voto!

deri në 250 ton pesticide të skaduara dhe produkte kimike industriale, materiale të tjera u depozituan në stacionin hekurudhor të Bajzës. Gjatë viteve 1991 dhe 1992, 480 ton substancë kimike të rrezikshme u importuan dhe u ruajtën përkohësisht në Bajzë. Më të rëndësishme nga këto substance kimike janë toxaphene dhe phenyl mercury acetate, që të dyja të ndaluara në Komunitetin Evropian që prej vitit 1983. Edhe pse një pjesë e madhe e tyre janë kthyer në Gjermani në vitin 1993 në mënyrë të sigurt, banorët nga zonat përreth morën shumë prej fuçive, duke zbrazur kimikatet toksike direkt në stacionin hekurudhor dhe zonat e depove.

06/09/2009

[aksin e Durrës-Kukës](#)

ME TE LEXUARA

[Ditari i Reshat Agajt: Takimi me Kadri Hazbiun,- E more Reshat ,a fitove luften](#)

[Skandalet seksuale ; Të majtët, më të ndezur](#)

[Historia e rrallë; Diplomati shqiptar që u internua nga KGB-ja si azerbajxhanas](#)

[Olldashi: Ju tregoj qeverinë e re të pas 28 qershorit](#)

[Rajmonda Stefa: Mund të jetë vrarë për konflikt pronësie](#)

[Atentati në Vienë, Zogu u kundërpërgjigj me armë](#)

[Mbreti Zog, si u zgjidh problemi i arit ne Egjipt dhe lufta me kancerin](#)

[Anila Jole, cdo dite jetoj nje histori](#)

[Ngjela braktis "Polin e Lirisë"](#)

[Roli i Zogut në konfliktin arabo-izraelit dhe frika nga spiunazhi komunist](#)